



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1227/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Florie Talla Asllani kandidate për anëtare të kuvendit komunal nga radha e PDK-së në Podujevë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës të votave, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Florie Talla Asllani, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Podujevë, nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK).

Arsyetim

Me datën 03.12.2013 në ora 15:37, Florie Talla Asllani kandidate për anëtare të kuvendit komunal nga radha e PDK-së ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se nuk është bërë numërimi i saktë i votave dhe në disa vendvotime ka pasur parregullsi, thuhet në pretendimet e ankuesit.

Parashtruesi i ankesë nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore të kandidates për anëtare të kuvendit komunal Florie Talla Asllani nga radha e PDK-së, janë të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindse pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi, për të vërtetuar shkeljen e supozuar andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 1227/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.